



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 699/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me apelin e parashtruar nga Bastri Bardhi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendsoje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Bastri Bardhi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendsoje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, me shenjën ZL.Anr.699/2017 e datës 09.11.2017, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 14:50, ka pranuar një apel nga Bastri Bardhi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendsoje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, i cili pretendon se në Shkollën Filllore Gradicë, Dobroshevc, Poklek i Ri, shkolla “Fehmi Lladrovci”, Gllanasellë, Gllogoc, Shkolla “Rasim Kiqina” votat janë numëruar keq, me dashje apo pa dashje dhe ka kërkuar që të rinumërohen votat në ato shkolla.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

apeli është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ne apel janë të pabazuara pasi që parashtruesi i apelit nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe sa pretendon se i posedon.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrat e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për apeluesin.

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë është e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.699/2017 më datën 11.11.2017.

Kryesuesja e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*